

# Info Epilepsia



Shtatzënia dhe epilepsia

Epilepsia mund të prekë këdo

# Lidhja e epilepsisë

## Hulumton – ndihmon – informon

### SHTATZËNIA DHE EPILEPSIA

Frikërat shpeshherë janë më të mëdha se sa rreziqet – në kohën e sotme epilepsia është një arsyje tejet e rrallë për të hequr dorë nga lindja e fëmijëve vetjakë. Gjithsesi, një shtatzëni e mundshme duhet planifikuar në kohën e duhur bashkë me neurologun<sup>1</sup> dhe me maminë – sipas mundësisë, qysh dy vjet më herët.

### Para shtatzënise

Epilepsia shumë rrallë është e trashëgueshme: më shumë se 95% e fëmijëve me prindër të prekur nga epilepsia nuk sëmuren nga epilepsia. Kësosoj, rreziku është vetëm pakëz më i lartë – në shumicën e rasteve jo sepse është trashëguar sëmundja, por për një predispositë që në situata të caktuara të zhvillohen krizat. Me probabilitet të lartë bëhet fjalë për ndonjë epilepsi të trajtueshme relativisht lehtë. Në rast se epilepsia paraqitet shpesh në familje, ose ekziston dyshimi për një formë të trashëgueshme të saj, mund të shpaguhej një ekspertizë gjenetike.

Faktori parashikues më i mirë për një shtatzëni dhe një lindje pa kriza (epileptike) është mungesa e tyre për së paku një vit përparrë barrësimit.

### Antiepileptikët

Gjatë planifikimit të një shtatzënie neurologu duhet ta optimizojë me kohë medikamentimin. Duhet synuar mundësish një trajtim me një medikament të vetëm (monoterapia), në dozat më të ulëta të mundshme. Është tejet e rëndësishme që neurologu përgjegjës i trajtimit ta njohë qysh përparrë hyrjes në shtatzëni pasqyrën medikamentoze, nën të cilën një grua nuk shfaq ndikime anësore dhe para së gjithash, nuk preket nga kriat.

Përmes marrjes korakte të medikamenteve dhe gjumit të rregullt ju si paciente mund të kontribuoni që doza të mund t'ju pakësohet. Sipas rastit, mund të jetë i arsyeshëm një kalim në një medikament tjetër – mirëpo një gjë e tillë mund të marrë shumë e shumë muaj. Gjatë kësaj kohe duhet të përdorni kontraceptivë të sigurt.

Duket sikur për fëmijën është më e favorshme nëse pasqyra medikamentoze të kishte sa më pak luhatje. Kjo gjë ndodh nëse antiepileptikët aplikohen në formë të “retarduar” ose nëse konsumohen të ndara në 3 deri 4 dozime ditore.

Një mungesë e **acideve folike**, që mund të jetë shkaktuar edhe nga antiepileptikët, e shton rrezikun për anomali. Për këtë shkak rekomandohet

një marrje e mëparshme e acideve folike në doza të larta (4-5 mg në ditë) qysh përparrë shtatzënise dhe gjatë tremujorit të parë të saj. Deri 50% e të gjitha shtatzënive nisen si të paplanifikuara; faza vendimtare në të cilën formohet sistemi nervor gjendet midis dites embrionale të 21-të dhe 26-të, që do të thotë, kryesisht përparrë se nëna e ardhshme të ketë idenë se është shtatzënë. Prandaj rekomandohet që **të gjitha** femrat në moshë shtatzënë të mbrohen me acide folike, **sapo** që të jetë diagnostikuar epilepsia. Në fletë-udhëzimet përcjellëse të preparateve të acideve folike pjesërisht tërhiqet vërejtja për kriat; ky “ndikim anësor” paraqitet tejet rrallë, nëse jo fare, dhe gjithashtu vetëm në rastin e epilepsive të mungesës (Absence-Epilepsie).

### Valproati

Medikamentet me substancë aktive Valproat ose acidet valproine (me emërtime tregu, në mes tjerash, Depakine®, Orfirl®, Convulex®), të marra gjatë shtatzënës, çojnë në anomali tek 4% deri 30% e fëmijëve, gjë që varet shumë nga dozimi. Përpos kësaj, mundet që në 30% deri 40% e fëmijëve, nënat e të cilëve kanë marrë valproat, të paraqiten çregullime zhvillimore (kufizime në intelekt, autizëm).

Kush merr tashmë valproat dhe do të mbetet shtatzënë, ose është tashmë shtatzënë, në asnjë rast nuk duhet ta ndërpresë medikamentin thjesht dhe në mënyrë të paautorizuar – një kriç me rënie për dhë mund të jetë më e rrezikshme për fëmijën e palindur bashkë me nënën se sa ndikimet anësore nga medikamenti. Femrat e prekura duhet që sa më parë të konsultohen me neurologun përgjegjës për trajtim.

Më së miri është që vajzat dhe femrat e afta për lindje të mos fillojnë, ose të mos vazhdojnë, trajtime me valproat. Marrja e valproat-it mund të lejohet vetëm atëherë kur vërtetë nuk ndihmon ndonjë alternativë tjeter. Sipas mundësisë, këto femra duhet të përdorin kontraceptivë. Në rast të dëshirës për shtatzëni, gjithmonë duhet synuar doza më e ulët e mundshme duke marrë njëkohësisht acide folike. Në rastin e dozave nën 700 mg në ditë, probabiliteti i një anomalie sillet në më pak se 5%.

### Gjatë shtatzënise

Sipas rregullit, trajtimi medikamentoz gjatë shtatzënës nuk duhet ndryshuar. Në veçanti mund të kalohet në medikamente të tjera vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në asnjë rast nuk duhet ndërprerë një medikament në formë të menjëhershme ose pa një konsultim paraprak

<sup>1</sup> Për shkak ekonomizimi kemi përdorur vetëm gjininë mashkullore. Natyrish që këtu nënkuftohen neurologët dhe neurologet.

me neurologun përgjegjës të trajtimit. Shtatzënati duhet të venë kontakt me kohë me neurologun që ta verifikojnë trajtimin medikamentoz.

Në rastin e disa antiepileptikëve – sidomos Lamotrigin, por edhe Levetiracetam – duhet bërë kontroll i pasqyrës medikamentoze qysh në fazën e hershme të shtatzënisë (më së voni nga muaji i dytë, ndërsa më pas, për çdo muaj), duke qenë se mund të paraqitet një rënje e ndjeshme e nivelit të saj për shkak të ndryshimeve hormonale. Në këtë rast neurologu përgjegjës i trajtimit duhet ta rritë dozën në atë masë sa të ruhet po ai nivel medikamentoz që ishte para paraqitjes së shtatzënisë.

Këto doza të shtuara **nuk paraqesin rrezik** për fëmijën që do të lindet, porse kësishoj do të mbahet në nivelin e duhur pasqyra e domosdoshme, mbrojtëse nga krizat, e antiepilektikëve. Dozat e shtuara janë të domosdoshme, ngase, gjatë shtatzënisë, mëlçia dhe veshkat kanë shumë më tepër punë dhe i shpërbëjnë shumë më shpejt medikamentet.

Eshtë me rëndësi një shoqërim i kujdeshshëm gjinekologjik gjatë shtatzënise, përfshire diagnostikimin e saktë me ultratingull. Rreziku për anomali, në rastin e fëmijëve me nëna të sémura nga epilepsia nën trajtim medikamentoz, eventualisht mund të jetë i ngritur, varësisht nga medikamenti. Sipas rregullit, shkalla e anomalive në një populatë normale (d.m.th. tek fëmijët e nënave që nuk kanë fare ndonjë sémundje dhe që nuk marrin fare medikamente) arrin në dy deri tre për qind.

Vrisni mendjen qysh përpara kontrollit se çfarë konsekuençash do të tërhiqni në rastin e një anomalie. Edhe atëherë kur për ju nuk vihet në diskutim një ndërprerje shtatzënie: kontrolllet janë të arsyeshme për një përkujdesje të mëvonshme optimale të fëmijës.

Komplikacionet gjatë shtatzënisë nuk janë më të shpeshta se sa tek femrat pa epilepsi.

## Rreziku për kriza gjatë shtatzënisë

Incidenca e krizave gjatë shtatzënisë kryesisht nuk ndryshon, gjithë përderisa pasqyra medikamentozë të mbahet konstante – madje afro 5% deri 10% e grave shtatzëna kanë më pak kriza se sa më parë. Seritë e krizave “Grand-Mal” dhe rëniet për dhë të kushtëzuara nga krizat mund të përfaqësojnë një rezik të theksuar për fëmijën e palindur, dhe për këtë shkak, mundësish duhen shmangur. Duhet të këshilloheni me mjekun tuaj se për cilat lloje të krizave janë të nevojshme ekzaminimet gjinekologjike.

Lindja

Në shumicën e rasteve është e mundshme një lindje e natyrshme. Indikacioni për një prerje cezariane paraqitet, ashtu si në rastin e të gjitha shtatzënive të tjera, ekskluzivisht nëse pozicioni i fëmijës do ta kërkojë një gjë të tillë, dhe nëse kjo i përgjigjet dëshirës së nënës të theksuar shprehimisht. Ajo duhet marrë në konsideratë edhe në ndonjë rast të rrallë, atëherë kur një grua ka kriza shumë të shpeshta, pastaj nëse edhe gjatë lindjes paraqiten kriza të rënda të përsëritura, ose nëse gruaja shtatzënë nuk bashkëpunon dot me maminë për shkak të krizave gjatë lindjes.

Në sallën e lindjes, në maternitet, nëna medoëmos duhet të marrë edhe më tej antiepilektikë. Këtë duhet ta ketë parasysh edhe babai i ardhshëm.

Për mbrojtje nga gjakderdhja tek foshnjat, menjëherë pas lindjes fëmijëve u jepen pika me vitaminë K. Kjo ka rëndësi të veçantë për fëmijët e nënave që marrin antiepileptikë enzim-induktues, duke qenë se këto mund të shkaktojnë një mungesë plotësuese të vitaminës K.

Gjidhënia

Sipas rregullit, gjidhënia është e rekomandueshme. Antiepileptikët, ndërkaq, mund të depërtojnë në qumështin e nënës, kështu që duhet mbajtur kontakt për këshillime me neurologun dhe me pediatrin. Kjo vlen sidomos për Phenobarbital-in ose Primidonin, mirëpo edhe për medikamentet e reja, me të cilat përvojat janë akoma të pamjaf-tueshme. Sot e kësaj dite, ndërkaq, antipeleptikët e përdorur më së shpeshti tek nënët e ardhshme, si Levetiracetam dhe Lamotrigin, depërtojnë në masë të konsiderueshme në qumështin e nënës. Mirëpo studimet kanë treguar se nivelet e tyre tek të porsalindurit janë **të papërfillshme** dhe nuk provojnë ndonjë ndikim të dëmshëm.

Në rast lodiheje të theksuar, vështirësive të mëkimit ose të çregullimeve të tjera të humorit të foshnjës, gjidhënia fillimisht duhet reduktuar, dhe në rast të përmirësimit të qëndrueshëm, të ndërpritet fare – jo në mënyrë të menjëherëshme, sepse mund të shfaqen simptomat e shkëputjes. Vlen një gjidhënie e rekomandueshme prej tre muajsh.

Lehonia

Brenda kat r jav e t  para pas lindjes pasqyra e serumit t  antiepileptik ve tek n nat mund t  rritet – n se doza  sht  rritur paraprakisht, duhet q  pas k shillimit me mjekun s rish t  reduktohet. Me k t  rast rekomandohet q  ky nivel n  vitin e par  t  jet  pak m  i lart  (25%-50%) se sa para fillimit t  shtatz nisi , duke gen  se mungesa e

gjumit, shqetësimet e brendshme dhe tendosja gjatë kësaj kohe mund të çojnë në një numër më të madh krizash. Për këtë shkak është e rëndësishme përkrahja për nënët – p.sh. mundet që partneri ta ushqejë foshnjën gjatë natës me qumështin e pompuar të nënës.

Nënët joimune ndaj krizave duhet që, nëse janë vetëm, fëmijëve t'ua ndërrojnë pelenat në dysheme dhe t'u japid gji në një kolltuk ose në krevat. Ato nuk guxojnë t'i lajnë bebet e tyre në vaskë dhe nuk duhet të përdorin vaska me aksesorë për bebe. Në rast se nuk është i pranishëm një person tjetër, fëmija duhet larë poshtë, nën dush, i ulur në dysheme, nën një cirkatë të dobët uji.

## Regjistri i shtatzénisë EURAP

Përmes regjistrimit ndërkombe tar të shtatzénisë organizatorët duan të marrin vesh se cilët antiepileptikë mund të shkaktojnë anomali ose çregullime zhvillimore. Në ndërkohë ky regjistër përmban informacione për mbi 20000 femra anembanë botës. Nëse merrni pjesë edhe ju, të dhënat tuaja do të përfshihen në formë anonime dhe nuk do të kenë ndikim gjatë trajtimit. Sa më shumë femra që të bashkëpunojnë, aq më shpejtë mund të përfitojnë njohuri të reja dobiprurëse.

## Epilepsia mund të prekë këdo

Së paku pesë për qind e njerëzve gjatë jetës së tyre vuajnë nga një krije epileptike. Afro një për qind e popullsisë sémuret nga epilepsia gjatë jetës së tyre. Në Zvicër bëhet fjalë për 70.000-80.000 persona, midis tyre 15.000-20.000 fëmijë.

### Lidhja e epilepsisë – shumëfish aktive

Lidhja zvicerane e epilepsisë hulumton, ndihmon dhe informon që nga viti 1931. Qëllimi i saj është përmirësimi i qëndrueshëm i përditshmërisë dhe gjendjes së të prekurve nga epilepsia në shoqërinë zvicerane.

### Hulumtimi

Ajo nxit zhvillimin e mëtejshëm të shkencës në të gjitha fushat e epilepsisë.

### Ndihma

Informacione dhe këshillime në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht:

- për të prekurit dhe familjarët
- për specialistët e fushave nga më të ndryshmet

### Informimi

Lidhja e epilepsisë informon dhe sensibilizon opinionin publik si dhe mbështet integrimin social të individëve të prekur nga epilepsia – si për shembull përmes kësaj broshure.

### Teksti:

Bazuar në broshurën „Epilepsie und Kinderwunsch“ (2017) nga, Prof. Dr. Bettina Schmitz, EURAP-Büro Deutschland, [www.eurap.de](http://www.eurap.de)

Bashkëpunëtorë:

Prof. Dr. Barbara Tettenborn, Prof. Dr. Stephan Rüegg

### Fletëpalosje të tjera në gjuhën shqipe:

Ç'është epilepsia?

Ndihma e parë në kriyat epileptike

Epilepsia tek të moshuarit

### Informacione të tjera

Në gjermanisht, frëngjisht, anglisht, pjesërisht italisht:

### Schweizerische Epilepsie-Liga (Lidhja zvicerane e epilepsisë)

Seefeldstrasse 84

CH-8008 Zürich

T +41 43 488 67 77

F +41 43 488 67 78

[info@epi.ch](mailto:info@epi.ch)

[www.epi.ch](http://www.epi.ch)

PC 80-5415-8

IBAN CH35 0900 0000 8000 5415 8

Fletëpalosja e aktualizuar herën e fundit: 02/2020

**Realizuar përmes ndihmës miqësore të:** Desitin Pharma GmbH, Eisai Pharma AG, Sandoz Pharmaceuticals AG, UCB Pharma AG. Sponsorët nuk kanë ndikim në përbajtje.

Pamja e ballinës: [www.istockphoto.com](http://www.istockphoto.com), VMJones